

NEPTUN Sh.p.k.

Pasqyrat financiare

për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "Neptun" sh.p.k.

Autostrada Tiranë Durrës, km. 0, Mbikalimi i Kamzes, Terminal Center,
Tiranë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare "Neptun" shpk, me NUIS K12222001B, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2017, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit në vijim, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqërise, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRFtë, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të shoqërisë, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm, që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Venis-Audit & Financë sh.p.k.

Vera Lala
Auditues Ligjor


Rr. Fadil Rada, P.Rruga Ura, Shk.1, Ap.2, Tiranë



Tiranë, më 27 Qershor 2018

Vjollca Dervishi
Auditues Ligjor

Rr. Frederik Shiroka, Pall.1, Shk.3, Ap.5, Tiranë



Përmbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar	4
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	6
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare.....	7
1. Informacion i përgjithshëm	8
2. Bazat e përgatitjes.....	8
3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet	9
4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet	10
4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)	11
5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	11
6. Aktive afatgjata materiale.....	16
7. Aktive afatgjata jo materiale	16
8. Të drejta të arkëtueshme.....	17
9. Të arkëtueshme nga palët e lidhura	17
10. Të arkëtueshme të tjera.....	17
11. Shpenzime të shtyra.....	17
12. Mjete monetare dhe të ngjashme.....	17
13. Inventari	18
14. Huatë nga institucionet financiare dhe hua te tjera.....	18
15. Kapitali	18
16. Detyrime tatimore.....	19
17. Të pagueshme ndaj punonjësve.....	19
18. Furnitorë dhe të tjera detyrime	19
19. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura.....	19

20.	Të ardhurat nga shitja e Mallrave e Shërbimeve.....	20
21.	Kosto e mallrave të shitur	20
22.	Të ardhura të tjera	20
23.	Shpenzime financiare Neto.....	20
24.	Pagat dhe shpenzimet e personelit.....	20
25.	Shpenzime operative.....	21
26.	Tatim fitimi.....	21
27.	Tatimi i shtyrë	22
28.	Të tjera Detyrime afatgjata.....	22
30.	Ngjarje pas datës së bilancit.....	22

Pasqyra e pozicionit financiar

Më 31 Dhjetor 2017

Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
AKTIVE		
Aktive afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	6 258,492,172	275,823,342
Aktive Afatgjata Jo materiale	7 -	6,620,222
Aktive Financiare		
Total - Aktive aftagjata	258,492,172	282,443,564
Aktive aftashkurtra		
Të drejta të arkëtueshme	8 1,044,769,167	1,033,773,673
Inventari	13 1,629,010,224	1,427,945,607
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	9 154,416,991	221,595,658
Të arkëtueshme të tjera	10 15,786,404	3,268,290
Shpenzime të shtyra	11 6,190,267	15,034,750
Mjete monetare dhe të ngjashme	12 329,568,257	432,887,147
Total - Aktive aftashkurtra	3,179,741,311	3,134,505,125
TOTAL AKTIVE	3,438,233,482	3,416,948,688
KAPITALI DHE DETYRIMET		
Kapitali aksionar	15 100,000,000	100,000,000
Rezerva ligjore	3,505,722	3,505,722
Rezerva të tjera	260,360,408	33,918,104
Fitimi i pashpërndarë	1,385,509	1,385,509
Fitimi i vitit	26 339,335,516	226,442,304
Total – Kapitali	704,587,155	365,251,639
Detyrime afatgjata		
Huatë nga institucionet financiare dhe hua te tjera	14 43,631,459	168,486,726
Detyrime për tatimin e shtyrë	27 -	2,255,213
Të tjera detyrime afatgjata	28 7,014,500	7,014,500
Total - Detyrime afatgjata	50,645,959	177,756,438
Detyrime afatshkurtra		
Huatë nga institucionet financiare dhe hua te tjera	14 750,703,013	759,630,906
Furnitorë dhe të tjera detyrime	18 1,779,937,709	1,907,065,981
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	19 43,851,742	126,688,859
Të pagueshme ndaj punonjësve	17 6,223,967	4,852,999
Detyrime tatimore	16 102,283,938	75,701,867
Total - Detyrime afatshkurtra	2,683,000,369	2,873,940,612
Total - Detyrime	2,733,646,328	3,051,697,050
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET	3,438,233,482	3,416,948,688

Këto pasqyra financiare, duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura në faqet 8 deri në 22, të cilat janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare janë miratuar dhe nënshkruar nga drejtimi më datë 31 Maj 2018 nga:

Aleksandros Kosenas
Drejtori i Përgjithshëm

Elton Serjani
Drejtori i Financës

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

		Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2017 LEK	Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2016 LEK
	Shënime		
Të ardhura nga shitja e mallrave	20	7,460,883,145	6,746,272,660
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	20	45,763,561	-
Kosto e mallrave të shitur	21	(6,177,704,668)	(5,658,039,920)
Fitimi Bruto		1,328,942,038	1,088,232,740
Të ardhura të tjera	22	47,862,390	35,049,614
Pagat dhe shpenzimet e personelit	24	(239,740,135)	(213,693,005)
Shpenzime operative	25	(678,745,981)	(590,654,192)
Fitimi Operativ		458,318,313	318,935,157
Shpenzime, financiare neto	23	(42,534,838)	(48,234,691)
Të tjera shpenzime financiare, neto		-	
Totali shpenzime financiare		(42,534,838)	(48,234,691)
Fitimi para tatimit		415,783,475	270,700,466
Tatimi mbi fitimin	26	(78,703,172)	(46,201,819)
Tatimi i shtyrë	27	2,255,213	1,943,658
Fitimi neto për periudhën		339,335,516	226,442,304
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i fitimit gjithëpërfshirës		339,335,516	226,442,304

Këto pasqyra financiare, duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura në faqet 8 deri në 22, të cilat janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare.




NEPTUN SH.P.K.
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Më 31 Dhjetor 2017

	Kapital i Nënshkruar		Rezerva Ligjore		Rezerva të tjera		Fitimi i Pashpërndarë		Totali	
	LEK		LEK		LEK		LEK		LEK	
Gjendja më 1 Janar 2016	100,000,000		3,505,722		33,918,104		106,724,473		244,148,299	
Efektet e riklasifikimeve pas aplikimit të SNRF										
Gjendja në 1 Janar 2016 pas rregullimeve	100,000,000		3,505,722		33,918,104		106,724,473		244,148,299	
Fitimi i vitit							226,442,304		226,442,304	
Rritje e rezervave nga fitimi i vitit							-105,338,966		-105,338,966	
Shpërndarje fitimi							227,827,813		365,251,637	
Totali i të ardhura përmblendhëse	100,000,000		3,505,722		33,918,104					
Rritje në kapitalin e nënshkruar							-		-	
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	100,000,000		3,505,722		33,918,104		227,827,813		365,251,637	
Fitimi i vitit							339,335,516		339,335,516	
Të ardhura përmblendhëse të tjera							-		-	
Rritje në rezerva nga fitimi i vitit					226,442,304		-226,442,304		-	
Pagesë Dividenti										
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	100,000,000		3,505,722		260,360,408		340,721,025		704,587,155	

Këto pasqyra financiare, duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura në faqet 8 deri në 22, të cilat janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare



NEPTUN SH.P.K.**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare****Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017**

		Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2017 LEK	Viti mbyllur më 31 Dhjetor 2016 LEK
	Shënime		
Aktivitetet e shfrytëzimit			
Fitimi pas tatimit	27	339,335,516	226,442,304
Rregullime për të rakorduar humbjen neto me fluksin neto të parasë			
Amortizime dhe zhvlerësime	26	69,032,784	67,105,084
Shpenzimet neto nga interesat			
Shpenzimet për Tatim Fitimin	27	78,703,172	46,201,819
Zhvlerësime për borxhin e keq		83,778,271	
Rregullime për kapitalin qarkullues:			
Zbritje/(Rritje) në inventare	14	(201,064,617)	(46,328,312)
(Rritje)/Zbritje në llogari të arkëtueshme	9.10.11	(139,961,443)	(277,404,738)
Rritje/(Zbritje) në detyrime ndaj punonjësve	18	1,370,968	1,166,310
Zvogëlim i shpenzimeve të shtyra		8,844,483	12,957,719
Zbritje në llogari të pagueshme	19	(183,383,318)	(29,249,283)
Mjetet monetare të përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit		56,655,816	890,903
Tatim Fitimi i Paguar		68,777,228	27,972,549
Interes i paguar		(40,586,257)	(48,234,691)
Mjetet monetare neto të (përdorura)/përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit		28,190,971	(20,262,142)
Aktivitetet e investimit			
Blerje aktivesh afatgjata material	7	(46,026,154)	(51,622,554)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(437,923)	
Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(46,464,077)	(51,622,554)
Aktivitetet financiare			
Emetim i kapitalit			
Pagesë Dividenti		-	(105,338,966)
Të ardhura nga huamarrje të reja	15	-	178,828,908
Shlyerje huamarrjeje		(133,783,159)	(54,921,526)
Mjetet monetare neto të përfituara/(përdorura) në aktivitetet financiare		(133,783,159)	18,568,416
Rritja/(rënia) neto e mjeteve monetare	13	(95,400,449)	(52,425,377)
Efkti i kursit të këmbimit	13	(7,918,440)	
Mjetet monetare në fillim të periudhës		432,887,146	485,312,524
Mjetet monetare në fund të periudhës	13	329,568,257	432,887,147

Këto pasqyra financiare, duhet të lexohen së bashku me shënimet shoqëruese të paraqitura në faqet 8 deri në 22, të cilat janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria “NEPTUN” Sh.p.k. është një shoqëri e themeluar në datë 24 Shtator 2001 sipas ligjeve të Shqipërisë, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS K12222001B, me një vlerë të kapitalit të paguar prej 100,000,000 LEK.

Qëllimi kryesor i shoqërisë është: Tregtimi i mallrave me shumicë e pakicë, Import-Eksport, i pajisjeve elektroshtepiake, etj, sipas objektit të veprimtarisë të përcaktuar në statutin e saj dhe të publikuar rregullisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Autostrada Tiranë -Durrës km 0, Mbikalimi i Kamzës, Terminal Center, Tiranë. Ajo ka në administrim 18 njësi shitje që ndodhen në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Administrator i shoqërisë është Z. Aleksandros Kosenas me afat emërimi deri më 29.05.2023.

Kapitali zotërohet nga ortakët :

BALFIN shpk, zotërues i 90% të kuotave, që përbëjnë 90% të kapitalit,
Z. JULIAN MANE, zotërues i 10% të kuotave, që përbëjnë 10% të kapitalit.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël (“IASB”).

b) Paraqitja e pasqyrave financiare

Shoqëria e paraqet pasqyrën e pozicionit financiar kryesisht sipas rendit të likuiditetit. Një analizë lidhur me arkëtimin ose shlyerjen brenda 12 muajve pas datës së raportimit (korrente) dhe më vonë se 12 muaj nga data e pasqyrave financiare (jo-korrente) paraqitet në shënimin 3.3.

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Shoqëria gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitet dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet dhe siç shpjegohet në mënyrë specifike në politikat kontabël të Shoqërisë.

c) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

d) Monedha funksionale dhe raportuese


Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë si rrjedhojë e mjedisit ekonomik ku operon shoqëria, ku të gjitha vlerat janë rrumbullakosur me vlerën e tyre nominale, përveç aty ku shprehemi ndryshe.

e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i Shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre çmuarjeve. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritik në aplikimin e politikave kontabël e që kanë efektin më të rëndësishëm në balancat e pasqyrave financiare janë përshkruar në shënimin 9.

f) Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që shoqëria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.



3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet

Standarte të reja dhe të rishikuara

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në apo pas datës 1 janar 2018.

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë në fuqi për periudhën raportuese:

SNRF 14 “Llogaritë e shtyra për Rregullatorët” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016).

Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” dhe SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për pëfshirjen me entitete të tjera dhe SNK 28 “Investime në sipërmarrje të përbashkëta” – Subjektet e investimeve: Përjashtim konsolidimi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).

Ndryshime në SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta” – Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacionet e përbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016).

Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare” – Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016).

Ndryshime në SNK 16 “Aktive afatgjata materiale” dhe SNK 38 “Aktive jomateriale” – Qartësim për metodat e pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016).

Ndryshime në SNK 16 “Aktive afatgjata materiale” dhe SNK 41 “Agrikultura” - Agrobiznes: Bimët prodhuese (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016).

Ndryshime në SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale” – Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016).

Ndryshimet e standardeve të ndryshme “Përmirësimet për SNRF- (cikli 2012-2014)” - që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e mënyrës së të shkruarit (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018).

Adaptimi i ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në Pasqyrat Financiare të Neptun shpk.

Standarde dhe interpretime në publikim ende jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare standardet, përmirësimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi.

SNRF 9 “Instrumentat Financiare” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018),

SNRF 15 “Të ardhura nga Kontratat me Klientët” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018).

SNRF 16 “Qiratë” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).

Ndryshime në SNRF 2 “Pagesat bazuar në Aksione” – Klasifikimi dhe Matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018).

Ndryshime në SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit” – Aplikimi i SNRF 9 “Instrumentat Financiarë” me SNRF 4 “Kontratat e Sigurimit” (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018 ose në momentin kur SNRF 9 aplikohet për herë të parë.)

Ndryshime në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta” - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose Sipërmarrje të Përbashkëta dhe ndryshimet e mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto është përfunduar)

Ndryshime në SNK 7 “Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare” - Iniciativa e informacioneve shpjeguese (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017)

Ndryshime në SNK 12 “Tatim fitimi” – Njohja e tatimeve të shtyra për humbje të parealizuara (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017).

(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Ndryshime në SNK 40 “Investime në Aktive Afatgjata Materiale” – Trasferimet e investimeve të aktiveve afatgjata materiale (efektiv në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018)

Ndryshime në standardet e ndryshme “Përmirësimet në SNRF-të (cikli 2014-2016)” që rezultojnë nga projekti i përmirësimit të përvitshëm i SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim shmangjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 12 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018)

Shoqëria ka zgjedhur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Shoqëria parashikon se adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të kenë impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuar nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht. Ndryshime në çmuarjet dhe vlerësimet kontabile njihen në periudhën në të cilën çmuarjet ndryshojnë dhe në periudhat e ardhshme që mund të preken nga ky ndryshim. Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atij të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njihet detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jetë i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do ndikojnë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

Aktivi tatimor i shtyrë njihet për humbjet tatimore të papërdorura deri në atë masë që është e mundshme që do të ketë fitim të tatueshëm, do të jetë i disponueshëm dhe kundrejt të cilit mund të shfrytëzohen humbjet. Është i nevojshëm gjykimi nga menaxhimi për të përcaktuar shumën e aktiveve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar mbi kohën e mundshme dhe nivelin e fitimit të tatueshëm prishem, së bashku me strategjitë për planifikimin tatimor.

Llogaritja e tatimit mbi fitimin dhe tatimit të shtyrë

Drejtimi beson se llogaritja e provigjionit të tatimit mbi fitimin është e përshtatshme pavarësisht pasigurive që ekzistojnë në legjislacionin në fuqi dhe mendon se vizitat e ardhshme fiskale nuk do të sjellin efekte të rëndësishme në pasqyrat e pozicionit financiar, rezultatit nga aktiviteti apo në flukset monetare. Gjithsesi, duke u bazuar në natyrën e ligjit mbi tatimin e të ardhurave dhe udhëzimeve përkatëse nuk është e mundur që të jemi të sigurt se pozicioni ligjor i tatimit mbi të ardhurat do mbetet i pandryshuar.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Në çdo datë bilanci Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të ndryshëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare konsiderohen të zhvlerësuar kur ka evidencë që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Shoqëria konsideron mundësinë e zhvlerësimit në nivel individual dhe kolektiv. Të gjithë aktivet financiare individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjithë aktivet e rëndësishme të cilat nuk zhvlerësohen specifikisht vlerësohen kolektivisht për çdo vlerësim që ka lindur por nuk është identifikuar akoma. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme vlerësohen duke grupuar bashkë aktivet financiare (të mbartura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta rreziku.

Evidencë objektive që aktivet financiare (duke përfshirë letrat me vlerë të kapitalit neto) të jenë të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagimin ose shkeljet nga klienti, huamarrësi, ristrukturimin e kredisë ose paradhëniet nga Shoqëria me kusht që Shoqëria nuk do të konsiderojë të dhënat që një huamarrës ose emetues do të falimentojnë, zhdukjen e një tregu aktiv për instrumentat financiarë, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme që lidhen me një grup aktivesh të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesve në grup, ose kushte ekonomike që lidhen me dështimin në grup.

(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Shoqëria përdor modelimin statistikor të trendeve historike të probabilitetit të mospagimit, kohës së rikuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Probabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rikuperimit krahasohen me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat. Trajtimi i zhvlerësimit në grup bëhet duke bashkuar investimet neto në qira financiare, bazuar në sektorin e industrisë së cilës ato i përkasin.

Aktivitetet financiare me kosto të amortizuar

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me koston e amortizuar maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktiveve. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritjeje kundrejt huave dhe paradhënies. Interesi mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes rikthimit të zbritjes, duke përdorur normën e interesit të përdorur për të skontuar flukset e ardhshme të parasë për qëllime të matjes së humbjeve nga zhvlerësimi. Kur një ngjarje e mëvonshme bën që shumën e humbjes nga zhvlerësimi të ulet, humbja nga zhvlerësimi kthehet (njihet) nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Rishikimi i zhvlerësimit

Rikuperimi i aktiveve është një çështje që kërkon gjykim të menaxhimit, që kërkon vlerësim nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të përshtatshme. Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare të ardhshme, janë të nevojshme supozime në lidhje me çështjet të pasigurta, siç përmendet më poshtë.

Standardet SNRF kërkojnë që menaxhimi të kryejë teste vjetore për zhvlerësimin e aktiveve dhe përcaktimin e jetës së tyre, gjithashtu kërkohet dhe vlerësimi i situatave të mundshme që do të sillnin mosrekuperimin e vlerës se aktiveve.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Regjistrimet kontabël të shoqërisë janë paraqitur në monedhën vendase "Lek", e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin.

Kurset e këmbimit të përdorura për vlerësimin e gjendjeve në valute me datë 31.12.2017 dhe 31.12.2016 janë:

Monedha	31. DHJETOR 2017	31 DHJETOR 2016
EUR	132.95	135.23
USD	111.10	128.17

Transaksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përkthyer me kursin mesatar të këmbimit për secilën periudhë, përveç rasteve të luhatshmërisë të ndjeshme të kursit të këmbimit, nëse ka, të cilat do të paraqiten me kursin e këmbimit të datës që ndodh transaksioni.

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha të drejtat e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur Shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'regjistron një aktiv në momentin kur

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**(c) Intrumentat financiarë (vazhdim)**

të drejtat kontraktuale për flukset e të ardhurave skadojnë, ose kur të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave transferohen me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe risqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivitetet e transferuara, paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi shlyhet, mbyllet ose përfundon afati i tij. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me kushte të ndryshme nga një tjetër po nga i njëjti kontraktor ose kushtet e detyrimit ekzistues modifikohen ndjeshëm, atëherë ai do të trajtohet si çregjistrim i detyrimit aktual dhe njohjes së një detyrimi të ri. Diferenca nga kryerja e transaksionit do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Detyrimet dhe të drejtat financiare netohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat jo derivativë të Shoqërisë përfshijnë të tregëtueshmet dhe llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj, të tregëtueshmet dhe llogaritë e pagueshme të tjera.

Paraja dhe ekuivalentët të saj

Paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë para dhe depozita afatshkurtra të përcaktuara si neto nga overdrafti i pashlyer në bankë.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë nga Institucionet financiare

Huatë e marra nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë llogaritje për koston e amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Të tjera

Instrumenta të tjerë financiarë jo-derivativ vlerësohen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi.

(d) Aktive afatgjata të investimit

Aktivi afatgjatë i investimit, i cila është një pronë e mbajtur për të marrë të ardhura në formë monetare dhe/ose për rivlerësime kapitale (duke përfshirë edhe prona për ndërtim për qëllime të tilla), vlerësohen fillimisht me kosto duke përfshirë edhe koston e transaksionit. Fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar kur risqet dhe përfitimet e pronësisë i janë transferuar shoqërisë pavarësisht nëse titulli i pronësisë i është transferuar asaj. Prona për investim fillimisht njihen me koston e tyre. Në vazhdim, prona për investim njihen duke përdorur modelin e koston.

(e) Aktive afatgjata materiale*Njohja dhe matja*

Aktivitet afatgjatë materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat përmbledhëse të tjera në lidhje fitime apo humbje të flukseve të parasë të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe paisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)*Njohja dhe matja (vazhdim)*

Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot në vijim

Kostot për zëvendësimin e një aktivi regjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast se është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivit ose çdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur.

a) Ndërtesa	5%
b) Makineri e Pajisje	20%
c) Mjete transporti	20%
d) Pajisje informatike	25%
e) Mobilje dhe orendi	20%

(f) Aktivet afatgjata jomateriale*Njohja dhe matja*

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin në vlerë të akumuluar.

Kostot në vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose çdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën lineare me një norme vjetore amortizimi 15%.

(g) Zhvlerësimet e aktiveve*Aktivitet financiare*

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në zhvlerësimin e tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e vlerësuar në të ardhmen nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Kompesimi (netimi)

Aktivitet dhe detyrimet financiare janë të kompensuara me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëqoftëse është ligjërësht e detyrueshme për të kompensuar shumën e njohur dhe ka si qëllim të mos fshahi bazën neto, ose të realizosh aktive dhe të fshish detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk lejohen të kompensohen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave, vetëm nëse lejohet ose kërkohet nga interpretimet e standardeve kontabël, si dhe në shënime shpjeguese të parimeve kontabël të entitetit. Humbja nga rënia në vlerë e aktivit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar i skontuar me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave (në humbje ose fitim). Interesi nga aktivet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)*Aktivitet jo-financiare*

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidencë e tillë për rënie në vlerë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontohehen për të arritur në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme.

Një humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave.

(h) Përfitimet e punonjësve*Kontributet e sigurimeve shoqërore*

Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

(i) Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen si aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë takse që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(j) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset neto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

(k) Të ardhurat nga shitja e mallrave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për tu marrë nga shoqëria. Të ardhurat reduktohen për kthimet e vlerësuar të klientit, uljet dhe skontot. Të ardhurat njihen kur ka prova për ekzistencën e tyre, të cilat identifikohen kur mallrat jepen ose shërbimet kryhen, si dhe rreziqet dhe përfitimet e lidhura me to janë transferuar nga shitesi tek blerësi, mbledhja e tyre është e mundshme, kostot e lidhura me to dhe kthimet e mundshme të produkteve dhe shërbimeve mund të maten në mënyrë të besueshme.

(l) Pagesat e qirasë

Qiratë klasifikohen si qira financiare kur kushtet e qirasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës. Shoqëria ka hyrë në marrëveshje qiraje për prona tregtare, dhe ka përcaktuar, bazuar në vlerësimet kushtet e marrëveshjes, ku zotëron të gjitha risqet dhe përfitimet mbi këto prona dhe për këtë arsye i konsideron ato si qira operative.

Shoqëria si qiramarrëse

Qiratë financiare që transferojnë rrezikun dhe përfitimet në mënyrë aksidentale tek shoqëria, janë kapitalizuar si një fillim i ri i qirasë me vlerën e drejtë të pronës së dhënë më qira, ose nëqoftëse është më e vogël me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qirasë. Pagesat e qirasë janë të ndarë midis pagesave financiare dhe uljes së detyrimit ndaj qirasë, për të arritur në një nivel konstant të interesit në tepicën e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare janë njohur si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një aktiv i dhënë me qira është amortizuar gjatë jetës së dobishme të tij.

Megjithatë, meqenëse shoqëria nuk ka një siguri që do të zotërojë pronësinë në fund të kohëzgjatjes së qirasë, aktivi do të amortizohet për një periudhë më të vogël se jeta e dobishme e tij. Pagesat e qirasë operative janë njohur si shpenzime operative në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Më 31 Dhjetor 2017, shoqëria ka qira financiare dhe operative duke vepruar si qiramarrës.

(m) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga këmbimi.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare. Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(n) Kostot e huave

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për tu sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati që qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(o) Shpenzime për tatim fitimin

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital, në të cilat rregjistrohen direkt në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit. Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

(p) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i shoqërisë është i njohur me vlerë nominale. Aksionet e zakonshme të shoqërisë klasifikohet si kapital.



NEFTION SULT.K.
Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2017

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

6. Aktive afatgjata materiale

	Makineri Pajisje dhe instalime	Mjete transporti	Mobilije dhe pajisje Zyre	Te tjere Aktive Afatgjata materiale	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	148,551,652	75,115,503	226,855,999	6,560,787	457,083,941
Shtesat nga Riklasifikimet pas aplikimit të SNRF					
Shtesa nga blerja	7,992,883	5,054,498	32,978,773	0	46,026,154
Pakësime		-2,954,603	-49,442	0	-3,004,045
Transferime	-	-	-	0	0
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	156,544,535	77,215,398	259,785,330	6,560,787	500,106,050
				0	

Giendia më 31 Dhjetor 2016

Shtesa e vitit	20,285,019	6,549,788	34,737,974	839,781	62,412,562
Pakësime		-2,027,133	-32,150	0	-2,059,283
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	70,536,005	46,252,271	121,623,938	3,201,664	241,613,878

Gjendja më 31 Dhjetor 2016

86,008,530	30,963,127	138,161,392	3,359,123	258,492,112
------------	------------	-------------	-----------	-------------

Aktivitet afatgjata jo materiale përbëhen nga shpenzime të nisjes dhe të zgjerimit në shumën neto 0 LEK në 31 Dhjetor 2017 (6,620,222 LEK në 2016) të cilat janë zhvlerësuar me normë 15 % në vit.

NEPTUN SH.P.K.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017***(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***8. Të drejta të arkëtueshme**

Të drejtat e arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Të drejta të arkëtueshme nga klient-ët	1,117,457,015	1,033,773,673
Të drejta të arkëtueshme Hua	11,090,423	-
Zhvlërim për kliente të paarkëtueshëm	-83,778,271	-
	1,044,769,167	1,033,773,673

Të drejta të arkëtueshme janë pa interes dhe zakonisht të arkëtueshme për një periudhë 5-30 ditore.

9. Të arkëtueshme nga palët e lidhura

Të arkëtueshmet nga palët e lidhura përbëhen nga të drejtat kundrejt kompanive të grupit në datë 31.12.2017 të cilat në total rezultojnë për vlerën 154,416,991 lekë dhe detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Balfin	154,229,141	202,845,000
Hua e dhënë afatshkurtër Neptun MNE	-	11,280,616
Kërkesa të Tjera	187,850	7,470,042
	154,416,991	221,595,658

10. Të arkëtueshme të tjera

Vlera e të arkëtueshmeve të tjera përbëhet nga të drejtat kundrejt Doganës për shkak të parapagimeve në datën e pasqyrave financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Parapagime për doganën	15,786,404	3,268,290
	15,786,404	3,268,290

11. Shpenzime të shtyra

Gjatë vitit 2017, shoqëria ka pasur shpenzime, të cilat i takonin më shumë se një periudhe. Kalimi i tyre në kosto është kryer duke u bazuar SNK 7: Të ardhurat edhe shpenzimet e shoqërisë për vitin ushtrimor raportues janë kontabilizuar sipas metodës së konstatimit të të drejtave dhe detyrimeve, që do të thotë se kontabilizimi është bërë në momentin kur transaksioni ekonomik ndikon mbi aktivet neto të shoqërisë.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Shpenzime të periudhave të ardhshme	6,190,267	15,034,750
	6,190,267	15,034,750

12. Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjetet monetare dhe të ngjashme deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Arka		
Arka në Lek	101,925,869	72,142,199
Arka në EUR	9,428,960	-
Arka në Tranzit	69,510,903	-
	180,865,731	72,142,199
Banka		
Llogari rrjedhëse në Lek	106,016,980	201,366,657
Llogari rrjedhëse në monedhë të huaj	42,685,546	159,378,291
Depozita afatshkurtër LEK	-	-
	148,702,526	360,744,948
Totali	329,568,257	432,887,147

NEPTUN SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

13. Inventari

Gjendjet e inventarëve të shoqërisë në fund të vitit ushtrimor janë vlerësuar dhe paraqitur në bilancin kontabël me metodën e koston mesatare të ponderuar të kostove të marrjes së tyre.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre, shoqëria vlerëson inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit. Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ka faktorë objektivë që tregojnë që inventarët janë zhvlerësuar. Në vlerën e inventarit të paraqitur në vijim është përfshirë edhe vlera e mallrave gjendje në magazinën doganore, e cila më 31 dhjetor 2017 ishte 123,635,656 LEK (në 31 dhjetor 2016 ishte 162,341,003 LEK).

Më poshtë jepet detajimi i postit të Inventarit në datë 31 Dhjetor 2017

	31 Dhjetor 2017 LEK	31 Dhjetor 2016 LEK
Gjendje mallrash për rishitje	1,628,326,385	1,427,945,607
Iventar i imet	683,839	-
	1,629,010,224	1,427,945,607

14. Huatë nga institucionet financiare dhe hua te tjera

Në këtë llogari janë paraqitur detyrimet e shoqërisë për **Huatë afatshkurtra**:

	31 Dhjetor 2017 LEK	31 Dhjetor 2016 LEK
Linjë overdraft Raiffeisen Bank	60,241,728	112,357
Linjë overdraft Tirana Bank	50,076,282	69,324,188
Linjë overdraft Societe Generale	-	33,614,049
Linjë overdraft NBG	-	15,910,871
Hua Afatshkurtër BKT	-	-1
Kredi Intesa San Paolo Bank	49,856,250	50,711,250
Huatë nga institucionet financiare	160,174,261	169,672,715
Hua të tjera pale te lidhura	199,425,000	-
Interesa për tu paguar	3,756,229	-
BALFIN SHPK	385,818,910	453,288,936
Detyrime ndaj ortakeve		135,230,000
Huatë te tjera nga ortake e pale te lidhura	589,000,139	588,518,936
Qira Financiare Leasing	1,528,614	1,439,256
	750,703,013	759,630,906

Në zërin e **Huamarrjeve Afatgjata** janë paraqitur detyrimet e shoqërisë për hua afatgjata bankare dhe hua te tjera referuar afateve kontraktuale.

	31 Dhjetor 2017 LEK	31 Dhjetor 2016 LEK
Detyrime ndaj ortakeve	-	67,615,000
Kredi Intesa San Paolo Bank	41,546,875	97,196,563
Qira Financiare Leasing	2,084,584	3,675,163
	43,631,459	168,486,726

15. Kapitali

Numri dhe vlera e kuotave te regjistruara ne 31 dhjetor 2017

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 kapitali i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqërisë është në vlerën LEK 100,000,000. Numri total i kuotave është 100 me vlerë LEK 1,000,000 për kuotë.

Tabela e mëposhtme paraqet pozicionin e ortakeve të shoqërisë dhe kontributet e tyre në 31 dhjetor 2017 dhe 31

NEPTUN SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

dhjetor 2016, në LEK:

Ortakët	% Kuotave	Kapitali i regjistruar në LEK (kontributi i paguar)	
		31/12/2017	31/12/2016
Balfin	90%	90,000,000	90,000,000
Julian Mane	10%	10,000,000	10,000,000
Total	100%	100,000,000	100,000,000

Shoqëria ka krijuar rezerva të tjera për të përballuar nevojat e saj për mjete financiare. Pra, me vendim të ortakëve shoqëria gjatë vitit 2017 nga fitimi i realizuar gjatë vitit 2016 ka krijuar rezerva të tjera për të përballuar nevojat e saj për mjete financiare vlerën prej 226,442,304 lekë.

16. Detyrime tatimore

Në llogaritjen e detyrimeve tatimore shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e Ligjit “Për Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, “Për TVSH-në”, për “Tatimin mbi të ardhurat” etj, të zbatueshme për aktivitetin e shoqërisë tonë. Detyrimet tatimore të papaguara me datë 31.12.2017 sipas natyrës së tyre dhe vlerat përkatëse janë paraqitur në tabelën e poshtëshënuar.

Detyrimet tatimore deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017 LEK	31 Dhjetor 2016 LEK
Detyrim për Tatim mbi pagat	1,236,160	1,142,674
Detyrime Tatim mbi qiranë	637,531	631,078
Tatim mbi fitimin për tu paguar	42,280,122	32,035,936
TVSH për tu paguar	58,130,126	41,892,178
	102,283,938	75,701,867

17. Të pagueshme ndaj punonjësve

Detyrimet ndaj punonjësve në 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017 LEK	31 Dhjetor 2016 LEK
Detyrime për Sigurime	4,663,671	4,109,504
Detyrime paga dhe shpërblime	1,560,296	743,495
	6,223,967	4,852,999

18. Furnitorë dhe të tjera detyrime

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitorëve. Në njohjen fillestare zërat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto Furnitorë dhe të tjera detyrime deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017 LEK	31 Dhjetor 2016 LEK
Të pagueshme ndaj furnitoreve	1,779,937,709	1,907,065,981
	1,779,937,709	1,907,065,981

19. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në këtë grup janë të përfshira detyrimet që kompania ka kundrejt ortakëve dhe kompanive të grupit të detajuara si mëposhte

	31 Dhjetor 2017 LEK	31 Dhjetor 2016 LEK
Detyrime ndaj Ortakëve	-	10,257,529
Detyrime ndaj shoqërive të grupit	43,851,741	116,431,330
	43,851,742	126,688,859

NEPTUN SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

20. Të ardhurat nga shitja e Mallrave e Shërbimeve

Të ardhurat nga shitja janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve të ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja. Paraqitja në pasqyrat financiare e të ardhurave e shpenzimeve është bërë sipas natyrës së tyre. Sipas Pasqyrës Përmbledhëse të të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, vlera e të Ardhurave nga shitja e mallrave përbëhet nga Shitje të kryera në 2017 brenda vendit në vlerën 6,560,643,815 lek dhe nga Exporte në vlerën 593,366,712 Lek. Të ardhurat nga shitjet për periudhën deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Të ardhura nga shitja e mallrave	7,154,010,527	6,640,488,610
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	45,763,561	-
Të ardhura të tjera	306,872,618	105,784,050
	7,506,646,706	6,746,272,660

21. Kosto e mallrave të shitur

Në këtë llogari janë të paraqitura kosto e mallrave të shitura gjatë vitit 2017 të listuara si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Blerja e mallrave	5,920,729,733	5,406,402,593
Transport në Blerje	46,494,429	45,082,142
Taksa Doganore	210,480,506	206,555,186
	6,177,704,668	5,658,039,920

22. Të ardhura të tjera

Të ardhurat neto nga transaksionet në valutë për periudhën deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Fitimi nga kursi i këmbimit	71,024,396	36,147,613
Humbje nga kursi i këmbimit	(23,162,006)	(1,097,999)
	47,862,390	35,049,614

23. Shpenzime financiare Neto

Shërbimet operative për periudhën deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Shpenzime interesa BG LC	3,149,172	5,089,591
Shpenzime Interesa OVD , Kredi	39,392,314	43,162,065
Të tjera	(6,648)	(16,965)
	42,534,837	48,234,691

24. Pagat dhe shpenzimet e personelit

Pagat dhe shpenzimet e personelit në 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Pagat	208,354,867	186,688,874
Sigurimet Shëndetësore e Shoqërore	30,292,457	27,004,131
Shpenzime Trajnimi	1,092,811	-
	239,740,135	213,693,005

NEPTUN SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

25. Shpenzime operative

Shpenzimet e operative për periudhën deri më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përfshijnë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Blerje energji, avull, ujë	35,963,073	19,560,649
Pastrimi	3,035,144	3,588,524
Nëntrajtime të përgjithshme	326,693	710,876
Qira	143,769,315	138,898,024
Ambjente te perbashketa	39,738,888	44,580,183
Mirëmbajtje dhe riparime	80,216,721	50,054,150
Të ndryshme	19,835,553	17,221,575
Security	11,260,565	11,938,529
Polica Sigurimi	3,242,811	2,502,495
Reklame, publicitet	76,971,804	87,717,797
Transferime, udhëtim, dieta	13,649,567	34,563,329
Shpz. postare e telekom.	6,338,615	6,408,694
Siguracion Makine	6,271,694	2,781,325
Për Karburant	17,499,936	10,275,873
Për Riparim Makinash	6,127,567	5,236,324
Shërbime bankare	13,696,914	15,417,309
Të tjera tatime e taksa	4,533,412	3,961,225
Kancelari	1,846,213	1,854,718
Të tjera shpenzime rrjedhëse	39,471,360	47,861,164
Amortizimi dhe zhvlerësimi	69,032,785	72,464,761
Shpenzime për AQT të shitura	944,762	-
Shpenzime për borxh të keq	83,778,271	-
Penalitete, gjoba, dëmshperblime	1,194,318	13,056,668
	678,745,981	590,654,192

Shpenzimi i Qirasë është faturuar kryesisht nga subjekte juridike si Mane-TCI, Tirana East Gate, TLP, Qendra Tregtare BlueStar, Qendra Imai etj.

Për kontratat me individët kompania ka paguar tatimin në Burim në masën 15% .

Shpenzimi i Marketingut përbëhet nga faturimi për fletëpalosjet, reklamat AudioVizive etj

Komisionet Bankare janë si rrjedhojë e rritjes së përdorimit të pagesave me kartë nga ana e Klienteve

26. Tatim fitimi

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2017 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15%. Niveli taksimit për fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2016 ka qënë 15%. Në vlerë nominale, tatim fitimi i llogaritur për vitin ushtrimor është 78,703,172 Lek. Për vitin ushtrimor shoqëria rezulton me një fitim neto të realizuar në vlerën 339,335,516 Lek:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Fitim kontabël i vitit	415,783,475	270,700,466
Të ardhura të pa tatueshme fiskalisht		
Shpënzime të pazbritshme	108,904,341	37,311,661
Shpenzime amortizimi mbi kufirin ligjor		
Shpenzime të tjera llog. (481)	13,996,235	13,996,235
Shpenzime për borxh të keq	85,331,144	-
Gjoba dhe kamat vonesa dhe të tjera	9,576,963	23,315,426
Humbja e pashpërndarë e vitit 2016		
Fitimi për vitin 2017	524,687,816	308,012,127
15% Tatim fitimi i vitit	(78,703,172)	(46,201,819)
Tatimi i shtyrë	2,255,213	1,943,658
Total	339,335,516	226,442,304

NEPTUN SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

27. Tatimi i shtyrë

Shoqëria llogarit tatim të shtyrë në 2017 dhe 2016 i cili lidhet me Shpenzime të periudhave të ardhshme të cilat do të amortizohen në vite. Pasqyra e tatimit të shtyrë dhe ndryshimet paraqiten si më poshtë:

	<i>Pasqyra e pozicionit financiar</i>		<i>Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave</i>	
	31/12/2017	31/12/2016	31/12/2017	31/12/2016
	LEK	LEK	LEK	LEK
Detyrime tatimore të shtyra				
Tatimi për shpenzimet e shtyra	-	2,255,213	2,255,213	4,198,870
	-	2,255,213	2,255,213	4,198,870
(te)/Kreditim tatim fitimi i shtyrë			(2,255,213)	(1,943,658)
Detyrim tatimor i shtyrë, neto	-	2,255,213	-	2,255,213

28. Të tjera Detyrime afatgjata

Shoqëria ka arkëtuar shumën prej 7,014,500 LEK si garanci nga VALA Sarandë SHPK për mardhënien franchise që ka me këtë shoqëri.

29. Transaksione me Pale të lidhura me efekt në Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	LEK	LEK
Blerje energji, avull, ujë	(6,596,012)	(5,182,006)
Pastrimi	(1,440,810)	(73,442)
Qira	(83,778,274)	(84,272,088)
Ambjente të përbashkëta	(32,305,962)	(35,504,285)
Mirëmbajtje dhe riparime	(68,947,610)	(42,690,837)
Të ndryshme	(15,963,455)	(14,793,863)
Security	(7,950,600)	(7,950,600)
Reklame, publicitet	(244,289)	(150,920)
Transferime, udhëtim, dieta	(10,831)	(25,000)
Shp. postare e telekom.	(190,632)	(122,998)
Kancelari	(6,526)	(74,272)
Të tjera shpenzime rrjedhëse	(3,548,585)	(465,740)
Për Riparim Makinash	-	(4,249)
Të ardhura nga shitja e mallrave	199,882,707	271,847,196
Të ardhura të tjera	1,702,354	645,336
Blerja mallrave	(10,999,108)	(115,997,586)
Sherbim Doganor	(2,437,500)	-
Shpenzime Interesa OVD , Kredi	(10,263,000)	(109,734)
Shpenzime trajnime	(1,028,545)	-
Fitimi nga kursi i kembimit	117,589	-
	(44,009,087)	(34,925,091)

30. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk kanë ndodhur ngjarje të tjera të mëtejshme pas datës së raportimit që të kërkojnë ndryshime apo rregullime të mëtejshme të pasqyrave financiare

Aleksandros Kosenas
Drejtori i Përgjithshëm

Tirane me 31 Maj 2018

Elton Serjani
Drejtori i Finances